

Prishtinë, 14.01.2008
Kodi i ZRRE-së: D_076_2008

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Nenit 15.2 (i) të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat e Nenit 38.7 të Ligjit për Energjinë Elektrike;
3. Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT Sh.A) për miratimin e Kodit të Pajisjeve Elektrike, të dërguar me datë 13 nëntor 2007, **në seancën e mbajtur me datë 14 janar 2008, ka nxjerrë këtë:**

VENDIM

I. MIRATOHET Kodi i Pajisjeve Elektrike të KOSTT Sh.A-së.

1. KOSTT SH.A. ka bërë kërkesë për aprovimin e Kodit të Pajisjeve Elektrike, të bazuar në obligimet që dalin nga dispozitat e Nenit 38.7 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
2. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka shqyrtuar, plotësuar dhe miratuar Kodin e Pajisjeve Elektrike të bashkangjitur kërkesës të KOSTT-it.
3. Kodi i aprovuar do të publikohet nga KOSTT-i brenda 5 ditë pune, pas njoftimit nga ZRRE-ja apo pas publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
4. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
5. Pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit ose nga data e publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
6. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike të ZRRE-së.

Bashkangjitur: Versioni i aprovuar i Kodit të Pajisjeve Elektrike.

Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Naim Bejtullahu, Anëtar

Nysret Avdiu, Anëtar